



## PROCESVERBAL I/2024

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

**Vendi:** Suharekë  
**Zyra:** Salla e Kuvendit të Komunës  
**Data:** 30.01.2024  
**Ora:** 13.00

---

### Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci  
Z.Selman Kolgeci  
Z. Flamur Bytyqi  
Z. Urim Suka  
Z. Kushtrim Kuçi  
Znj. Elmaze Bytyqi  
Znj. Bulëza Kuçi  
Znj.Doruntina Zenelaj  
Z.Alban Berisha  
Z. Bexhet Kuçi  
Z. Reshat Selimaj  
Z. Lirim Qatani  
Z. Aziz Bytyqi  
Znj.Sanie Kuçi-  
Rexhepaj  
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina  
Z. Vullnet Luzhnica  
Z. Xhevshet Gashi  
Z.Edon Sadikaj  
Znj.Saranda  
Bajraktari  
Znj.Mimoza Bajraktari  
Znj.Festë Kabashi  
Z.Dardan Berisha  
Z.Bajram Basha  
Znj.Mevlude Kabashi  
Znj.Sheqerije Zyrapi  
Znj.Laureta Tafaj  
Z.Liridon Fandaj  
Z.Qëndrim Elshani  
Z.Herolind Limaj  
Znj. Jehona Rrafshi

### Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës  
Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### **REND DITE**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2022 të Komunës së Suharekës;**
- 6. Informatë për aktivitetet e KKSb-së;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** - para se të hedh në votim rendin e ditës kërkoj nga ju anëtar të Kuvendit që ta fusim edhe një pikë shtesë në rend dite e cila është: Raporti i ekipit të auditimit social në Suharekë.Është kërkesë e organizatës joqeveritare Birn nga Kosova në bashkëpunim me organizatën Demos.Raportin do ta prezantoj Rrahman Rama nga organizata Birn Kosova.Është raport që nuk do të votohet dhe unë kërkoj nga ju që të futet si pikë shtesë në rend dite.

**Urim Suka** - duke falenderu organizatën për sjelljen e raportit dhe prezantimin që do ta bëj por ne nuk e kemi pas këtë material dhe nuk e kam ende para vetes.Nëse do ta prezantojë,në rregull por ne nuk mund të diskutojmë pa e analizu një raport.Nuk e di arsyen se pse nuk na ka ardhë ky material më herët.Kërkoj sqarime pse në moment të fundit po na vje.

**Kryesuesi** - unë kam kërku në shkurt me sjell këtë pikë mirëpo këta thanë që duhet patjetër në janar të përfundohet sepse deri në fund të muajit duhet ta përmbyllin si raport.

**Urim Suka** - a është çështje e organizatës që nuk e ka sjell me kohë apo çështje e neglizhencës së institucionit komunal?

**Kryesuesi** - faktikisht këta në fund të dhjetorit e kanë sjell si një kërkesë por unë nuk e kam pa të arsyeshme me sjell një raport të një organizate këtu mirëpo pasi e kemi kry KPF-në e kemi diskutu që është dasht ta sjellim.Në një formë ka qenë edhe neglizhencë që nuk është sjell me kohë.

**Qëndrim Elshani** - ndoshta më mirë është ta lëmë muajin tjetër dhe dimë se çka të diskutojmë paraprakisht dhe besoj kjo është më e udhës.

**Jehona Rrafshi** - unë mendoj që duhet me ia dhënë hapsirën kësaj organizate me prezantu raportin pastaj të vazhdojmë me diskutime.Për deri sa nuk kemi me votu,mos të humbim kohë me debate.

**Flamur Bytyçi** - mendoj që është mirë të shtyhet seancën e radhës në mënyrë që të përgaditemi edhe ne si asambleist.

**Kryesuesi** - e kemi bisedu me Rrahmanin që me lënë për seancën tjetër që edhe ju me qenë më të informuar por mbas dite më informoi që i kanë thënë që duhet patjetër me qenë si pikë shtesë.

**Urim Suka** - e kërkoj mirëkuptimin e organizatës që kjo temë të trajtohet muajin e ardhshëm.

**Alban Berisha** - propozoj që këta ta bëjnë prezantimin sot në bazë të akteve të organizatës së tyre dhe të kryhet si pikë shtesë e rendit të ditës por kërkoj prej jush Kryesues që seancën e radhës me sjell këtë raport si pikë shtesë për me pas mundësi ne që ta shqyrtojmë ose me debatuar rreth raportit.

**Kryesuesi** - dy herë po diskutohet ajo pikë.

**Alban Berisha** - a shkelet ligji nëse e sjellim prap seancën e radhës?

**Avni Bytyqi** - s'ka efekt .

**Alban Berisha** - nëse s'ka efekt pse nuk e keni sjell më herët? Nëse është informatë, pse mos me ardhë edhe sot edhe seancën tjetër.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

**19 për,8 kundër,3 apstenime**  
**Miratohet pika shtesë**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

**19 për,9 kundër,2 apstenime**  
**Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - pasi nuk ka vërejtje e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga partitë politike.

**Aziz Bytyqi** - grupi i AAK-së propozon Mimoza Bajraktarin.

**Selman Kolgeci** - grupi i LDK-së propozon Bulëza Kuçin .

**Dardan Berisha** - Grupi i PDK-së nuk ka kandidat për këtë komision.

**Qëndrim Elshani** - grupi i LVV-së propozon Laureta Tafaj.

**Kryesuesi** - Laureta ka qenë në komision dhe ka dhënë dorëheqje. A keni propozim tjetër?

**Qëndrim Elshani** - kjo nuk ka qenë arsyeja që ne e kemi dështu komisionin.

**Liridon Fandaj** - Laureta ka dhënë dorëheqje pasi nuk ka pas kuorum dhe i gjithë komisioni ka dhënë dorëheqje para Lauretës. Më jep interpretim ligjor nëse thua që nuk bën.

**Avni Bytyqi** - një kandidat që ka qenë në komision dhe ka dhënë dorëheqje, nuk ka të drejtë morale me hy në atë komision dhe as të diskutojë.

**Liridon Fandaj** - unë kërkoja ligjërisht dhe jo moralisht dhe nëse ti ia mohon atëherë ne kemi të drejtë me u anku kundër atij vendimi që ti ia mohon dikujt me qenë pjesë e komisionit. Ti merre propozimin dhe nëse nuk kalon në rregull.

**Avni Bytyqi** - ka edhe rregulla dhe norma të cilat rregullojnë qështje të caktuara pa rregullore dhe ligj.

**Jehona Rrafshi** - Nisma Social Demokrate nuk do të jetë pjesë e komisionit.

**Herolind Limaj** - nuk kemi propozim për këtë komision.

**Dardan Berisha** - ky komision i përmban tre anëtar të Kuvendit dhe ne tre i propozuam. Nëse ligji nuk e lejon kthehet prap por le të propozohet Laureta.

**Kryesuesi** - ne jemi dëshmitar që ajo ka dhënë dorëheqje dhe mos po biem ndesh.

**Nënkryetarja** - nga ekzekutivi propozojmë Visar Kuçin-drejtor i Urbanizmit dhe Armend Krasniqi-drejtor për Katatër dhe Pronë.

**Liridon Fandaj** -atëherë nëse Laureta nuk bën,nuk bën edhe drejtorat sepse ata kanë qenë të njejtit në komision.

**Kryesuesi** - ata nuk kanë dhënë dorëheqje.

**Liridon Fandaj** - nuk ka pas kuorum kur ka dhënë Laureta dorëheqje.

**Shefket Kolgeci** - nëse ana ligjore e pengon,pse me e shty këtë procedurë por nëse ana ligjore e lejon unë kisha thënë të futete propozimi.

**Kryesuesi** - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Mimoza Bajraktari,Bulëza Kuçi,Laureta Tafaj, Visar Kuçi dhe Armend Krasniqi.

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kur kemi te vendimi për të cilin obligohemi sot me shfuqiziu, më kujtohet debati i seancës kur e kemi miratu këtë vendim dhe e kemi pa një lloj krekosje mes dy drejtorave se cili i ka pas meritat më shumë, drejtori i Katastrës apo drejtori i Arsimit. Drejtori i Arsimit e merr fjalën dhe thotë që kjo çështje është ekskluzivisht e imja dhe thotë që jam duke punu që tri vite me këtë çështje. Paramendoni, drejtori i Arsimit i ka shpenzu tri vite kohë për me sjell në Asamble dhe kur ka ardhë në Asamble ai vendim ka dal të jetë që nuk është bë si duhet. Nëse iu kujtohet, ne kemi dal dhe i kemi dhënë vërejtjet tona dhe jemi mundu me i dhënë sqrimet tona që ky vendim është i përgaditur keq dhe kemi kërku interpretime dhe nuk i kemi marrë përgjigjet e duhura dhe ju keni vendos me shty tutje. Tani unë kërkoj sqarim prej drejtorit të Arsimit dhe drejtorit të Katastrës se ku jemi me këtë pikë dhe a po ndiheni keq që tri vite të drejtorit të Arsimit paskan shku dëm me një vendim që sot detyrohem me shfuqizu.

**Armend Krasniqi** - iniciativën të cilën e kemi marrë për ndryshimin e emërtimeve të shkollave ka qenë e mbështetur edhe në KPF dhe në Asamble unanimitisht nga asambleistët. Emrat ekzistencial janë skandaloz dhe duhet të ndryshohen mirëpo ministria e ka kthyer që nuk është e ligjshme. Jemi konsultu edhe një herë me sekretaren e Ministrisë së Arsimit dhe do ta provojmë dhe një herë përmes Asamblesës ose përmes një udhëzimi administrativ të cilin na ka dhënë dhe kjo çështje do të rregullohet shumë shpejtë. Ne nuk kemi pa asnjë pengesë ligjore dhe për deri sa nuk kemi pa asnjë pengesë ligjore, çoftë zyra e Kryetarit e që në këtë rast ka qenë e pa përgaditur dhe u dasht të konsultohet më mirë me zyrtar ligjor të cilët paguhen për këtë punë por unë dua ti bëj fajtor edhe partitë politike që nuk e kanë gjet pikën pse nuk duhet me qu më tutje.

**Remzi Bajselmani** - është e vërtetë që tri vite jam angazhu që të bëhet ky ndryshim i emrit të pronave të shkollave dhe të vendosen emrat legjitim. Edhe drejtorët para meje kanë punu në këtë drejtim. Prap do të mundohemi dhe s' do të ndalemi deri sa të rregullohet. E kemi bë kërkesën përmes drejtorisë për pronë dhe katastrof dhe ata janë sponsor të këtij ligji.

**Urim Suka** - ne e kemi përkrah si ide dhe prap do ta përkrahim si ide por problemi është që ju jeni bartës të këtyre proceseve dhe jeni duke punu keq dhe sot po thoni se pse ju nuk na keni përmirësuar. Ju e keni përgjegjësi. Ne jemi mundu me dhënë kontributin tonë ku i kemi dhënë edhe vërejtjet tona.

**Kryesuesi** - Urim faleminderit por mua më pëlqeu Armendi ku tha se ne ja kemi nis. Pa ia nis asnjë punë nuk kryhet edhe pse në fillim ndoshta ka edhe neglizhencë.

**Shefket Kolgeci** - ne nuk po themi pse e keni bë por pse po i bëni keq. Ka plot projektvendime që i keni sjell me i shfuqizu. Jeni qeveri jo e aftë.

**Liridon Fandaj** - sa i përket asaj që është politike, ajo është ligjore dhe jo politike por drejtorit po i përzihen nganjëherë. Në zyrën ligjore punojnë disa zyrtar që janë moti në ministri dhe që janë të Aleancës. Ne e kemi mbështet iniciativën e drejtorit dhe edhe ajo u kthyer si shumë vendime tjera. Unë ju propozoj të angazhoni një zyre ligjore private që mos me u kthyer sepse të paktën janë kthyer 20 vendime jo ligjore.

**Armend Krasniqi** - Liridon dhe Urim, u kthyer një vendim që është më i rëndësishëm dhe që është i mirë për të gjitha partitë politike. 23 vite nuk është marrë askush me këtë punë por tash ia kemi nis me u marrë.

**Shefket Kolgeci** - ne nuk kemi thënë pse e keni sjell por shumë mirë që e keni sjell. Ne iu kemi ndihmu dhe prap do të ju ndihmojmë por pse mos me kry me kohë dhe mos me e shfuqizu.

**Remzi Bajselmani** - ju garantoj me gjithëçka që nuk kam pas idenë që ka bo naj politikë shqiptare ose naj parti politike për vendimin. Vendimet e tilla janë pak të ndieshme te prona. Askush nuk është dëmtu për një muaj që e kemi provu me e bë këtë të mirë në Komunë dhe prap do të provojmë me e bë mirë dhe pa tendenca.

**Alban Berisha** - Drejtori i Arsimit tha që edhe drejtorat paraprak janë marrë me këtë punë por ka ardhë puna që ti me finalizu si proces në një masë drejtor. Drejtor, ti je i PDK-së dhe jeni në koalicion. Më duket që ke marrë elemente të Kryetarit duke thënë se keni me kry. Nuk shkon puna në aspektin ligjor kemi me kry diqysh. Ajo kryhet me ligj. Ju jeni drejtori aty dhe keni jurista boll dhe nëse ata nuk e njohin mirë ligjin e pronave, mos prit që një jurist i lëmisë së përgjithshme që ka me qenë i fokusum aty dhe duhet me i ditë të gjitha ligjet por ata të drejtorisë tënde duhet me i ditë saktë. Ti je i thirrur me kry një akt deri në fund sepse je sponsorizues. Zyra ligjore e shqyrton dhe në këtu e debatojmë por ne nuk jemi një kolegji i juristave që kemi me marrë një vendim a është ligjor apo jo. Ne sigurisht e kemi mendu që kjo pikë është pozitive dhe duhet me ec përpara kurse shqyrtimi është direkt barrë e jotja me administratën e drejtorisë tënde. Realisht drejtor ti duhesh me u mburrë me punën tënde por duhet edhe me na kërkua falje që na ke qit në lajthitje neve si asambleista sepse na ke pru me votu një vendim jashtligjor. Në fillim kur e keni fillu punën si administratë ekzekutive, ju kam thënë të keni kujdes sepse nganjëherë shumica absolute e votave e anashkalon demokracinë dhe nuk është pozitive. Mandatin e kaluar që nuk e ka pas Kryetari shumicën, shumë më pak ka pas vendime që janë kthyer sepse jemi konsultu se si me bë një vendim më të mirë. Këtë vit e keni arrogancën e numrave dhe ju bën me u ngut dhe me marrë vendime politike dhe në raste të caktuara ju kthehen shumë shpesh. Për juve ka qenë faktori numër shumë me rëndësi se sa faktori produktivitet. I kisha lut të gjithë drejtorat që vendimet ti shqyrtoni paraprakisht dhe kur ti sillni te ne, mos pritni prej neve me bo shqyrtim ligjor sepse ne e bëjmë shqyrtimin politik. Nëse keni dëshirë prej nesh me bo shqyrtim ligjor, njëra prej propozimeve të mijs ka qenë që ta sillni draft.

**Armend Krasniqi** - më pëlqeve në shumë pika mirëpo kur the se na ke qit në lajthitje! një intelektual si je ti, një jurist i përgaditur, një asambleist që i ke marrë mbi 600 vota dhe me ardhë një drejtor që s'është jurist dhe me qit në lajthitje, nuk është detyra ime. Kemi marrë një veprim që nuk u mendu me u marrë nga askush që 23 vite. Drejtori tuje jep sqarime rreth vendimit.

**Dardan Berisha** - është e vërtetë që ne si Asamble e kemi mbështet si vendim dhe nuk po ndalemi te arsyetimi se pse e ka kthyer ministria. Drejtori i Arsimit e cekti që është vendim më shumë politikë por unë nuk mendoj ashtu. Në arsyetimin që është dhënë prej ministrisë thuhet: 1. I mungon baza ligjore. A e keni dorëzuar këtë apo nuk e keni dorëzuar? 2. Paqartësi në konstatimin se ka të bëjë me ndërrimin e emërimit të shkollave apo titullarit të pronës. 3. Emërimit të shkollave të cilat pretendoni ti ndryshoni. Ju si ekzekutiv a i keni dorëzuar këto tri pika apo nuk i keni dorëzuar? Mos të dalim para aktit të kryer si anëtar të Kuvendit.

**Avni Bytyqi** - vendimi nuk është i kundërligjshëm por vendimi nuk ka bazë ligjore. Unë edhe në KPF e kam thënë që me Ministrinë e Planifikimit Hapsinor dhe të Mjedisit, jo vetëm Komuna jonë por të gjitha Komunat e RKS kanë problem me çështjen e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve që miratohen nga Kuvendi për arsye se Ministria e Planifikimit Hapsinor e don decidivisht bazën ligjore se ku e jep me nxjerr atë akt nënligjor Kuvendi i Komunës. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3 për shfuqizimin e vendimit.

### Unanimisht Miratohet pika 3

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe hap debatin.

**Labiot Halitjaha** - drejtori për Ekonomi dhe Financa thotë që Kuvendi Komunal Suharekë në shtator të vitit 2022 ka votu buxhetin për vitin 2023 në vlerë 19.807.000 €, të barturat e vitit 2022 janë në vlerë 917.000€ dhe donacione dhe granti i performance i ka arrit afërsisht 21.112.000€ ndërsa si buxhet i alokuar është vlera 22.677.000€. Komuna jonë ka pas planifikim për të hyra vetanake afërsisht 2.193.000 ndërsa ka tejkalu të hyrat vetanake në 2.684.000. Buxheti i Komunës së Suharekës është shfrytëzuar te granti qeveritar rreth 94.7 %, te fondi burimor vetanak 49.08 %, te mjetet vetanake të bartura rreth 69.66% dhe te donacionet 99.72 %. Si suficit te granti qeveritar kemi rreth 265.880€ te kapitalet ndërsa te granti vetanak kemi 520.000, te bartja e mjeteve 268.000 dhe te donacionet janë rreth 1.000.000. Drejtori tutje jep sqarime.

**Fadil Hoxha** - zyrtari kryesor financiar elaboron raportin financiar të ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Suharekës.

**Liridon Fandaj** - te pjesa e pasqyrave përfundimtare, te buxheti i alokuar është 19.178.886. Nëse e marrim buxhetin fillestar dhe të hyrat vetanake të 2023-tës na jep këtë shifër por ti prap i ke vendos të njëjtën shifër te të hyrat vetanake dhe i ke mbledh dhe ka t'ka dal 22.667.570. A ka të hyra tjera apo është gabu edhe kjo pjesë?

**Fadil Hoxha** - te pjesa e buxhetit të RKS-së është pjesa e shtimit të pagave për shkak se pagat janë me ligjin e ri të buxhetit ku komplet pagat e kanë kalu 1.564.000 diferencën mes pagave që kanë qenë pa ligjin e ri të pagave. ZKF tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - ne e kemi diskutu në KPF dhe e kemi lënë që në Asamble me na ardhë raporti si duhet.

**Fadil Hoxha** - nuk kam mujt me të sjell raport sepse ndryshimet kanë ndodh shpesh. Raporti ka me dal në web faqe dhe mund ta shohësh krejt çka ka dhe çka nuk ka.

**Liridon Fandaj** - kërkesa ime ka qenë që nëse nuk është në rregull, mos t'na vje një raport edhe ne s'mund të diskutojmë. Të paktën sqarimet se vlera e buxhetit ku po ndryshon te buxheti i alokuar. Unë duhet me studiu dhe me i nxjerr për një kolonë që ne nuk e kemi për shkak të rritjes së pagave me dit për çka ka ardhë. Besoj se suficitit nuk ia keni huq.

**Elmaze Bytyqi** - pse nuk po i procedoni në kohë pagesat që devirojnë nga kontrata kolektive sektoriale në arsim dhe shëndetësi por po obligoheni të paguani shuma të mëdha pas vendimeve gjyqësore të cilat rëndojnë buxhetin komunal.

**Fadil Hoxha** - ky nuk është obligim i organizatave buxhetore. Këto kontrata janë bë kolektive kur kanë qenë ministrat e kryeministrat që i kanë bë me sindikatat. Ato i kanë lënë pjesë të vetat e jo të komunave mirëpo për me i ik përgjegjësisë së vet i kanë bartë te komunat. Të gjitha komunat e kanë këtë problem.

**Elmaze Bytyqi** - a mundeni ju me i pagu me kohë para se me i marrë?

**Fadil Hoxha** - neve na e kanë lënë barrën me i kry obligimet por megjithatë nuk i kanë marrë prej buxhetit tonë. Nuk është në rregull por nuk na takon neve si organizatë buxhetore.

**Shefket Kolgeci** - sa mjete kjo qeveri i ka humb dhe kanë shku në buxhetin e konsoliduar të Kosovës?

**Fadil Hoxha** - 451.000 kanë shku në buxhetin e Kosovës. Kanë qenë për me u shpenzu por nuk janë shpenzu.

**Urim Suka** - e keqja e këtij diskutimi është që fajtori kryesor për krejt këto zhvillime sot e ka zgjedh rrugën me ik dhe mos me ardhë me u ballafaqu me këtë keq menaxhim të buxhetit të vitit 2023 që e ka bë. Nëse e analizon mirë këtë raport e kupton qartë se këtë pushtet, keqplanifikimi keqmenaxhimi, anashkalimi

i vendimeve të Asamblesë dhe paaftësia për ti implementu projektet që vet kanë miratu, po e përcjell nga viti në vit. Madje ky vit është edhe më keq se vitete tjera. Këtij pushteti i kanë mbet 2 milion euro pa shpenzuar nga viti 2023. Në raportin që ju e keni sjell figuron që 451.937€ ka mbetur suficit për vitin 2023. Pra ky pushtet ka dështuar të shpenzoj mjetet e alokuara nga fondi burimor i RKS-së dhe këto mjete kthehen në Qeveri. Është edhe më i çuditshëm fakti që ky pushtet ka dështuar të shpenzojë mjetet nga të hyrat vetanake në vlerë prej 1.583.902 €. Madje kësaj shifre do ti shtohen edhe mjetet nga dënimet e trfaikut dhe gjykatave për tre mujorin e fundit të vitit 2023. Dikur Kryetari Muharremaj kritikonte për bartjen e 350.000€ ndërsa sot ky Kryetar sjell raportin me të cilin dëshmon që mjetet e pa shpenzuara për vitin 2023 janë mbi 2 milion euro. Në këtë raport figuron se për projektin "Vorrezat e qytetit" janë shpenzu rreth 200.000€ mirëpo ajo që shihet në teren është se atje kemi vetëm gërmime të dheut dhe betonizim. Pra ky pushtet nuk është as afër për ta përmbyll këtë projekt. Në këtë raport figuron që për ndërtimin e rrugës "Skënderbeu", "Aleksandër Mojsiu"-seg. dhe "Bajram Curri"-seg. në Suharekë, ky pushtet ka shpenzuar rreth 300.000€. Unë isha dhe i vizitova këto rrugë dhe vetëm në rrugën "Bajram Curri" pash një segment shumë të shkurtër që është shtruar ndërsa te dy rrugët: "Skënderbeu dhe Aleksandër Mojsiu nuk pash që është investu në ndonjë segment. Kërkoj të di nga ju se në cilat rrugë janë investu 300.000€?

Në këtë raport figuron që për ndriçim publik janë shpenzuar 258.774€, mirëpo problemet me ndriçim publik vazhdojnë të jenë prezente në shumë vendbanime. Për ndërtimin e aneksit në shkollën "Besim Ndreca" në Maqitevë janë shpenzuar 109.000€ mirëpo sipas informatave që kam, atje janë vendos vetëm

themelet dhe nuk është punu diçka tjetër. Kjo lë të kuptohet që janë bërë pagesa ende pa përfunduar punët dhe nëse është kështu, kjo është shkelje. Dyshime të tilla se janë bërë pagesa pa përfunduar punët ka edhe në projekte tjera. Prandaj nevoja për formimin e komisionit të përbashkët për ti verifikuar të gjitha këto dyshime është e madhe. Në këtë raport figuron që në fshatin Samadraxhë janë shpenzuar rreth 121.000€ Ndërsa për projektin e ndërtimit të rrugëve “Bunari i Limanit dhe Fehmi Morina” figuron që janë shpenzuar 200.000€. Mirëpo unë isha në Samadraxhë dhe i vizitova këto rrugë dhe nga banorët atje kuptova që projekti “Unaza e Samadraxhës” ka përfshirë edhe rrugët “Bunari i Limanit dhe Fehmi Morina”. Këtu kemi të bëjmë me keqplanifikim sepse këto rrugë rezultojnë që janë planifiku dy herë me emra të ndryshëm. A mund të më tregoni se cilat rrugë janë shtruar me këto mjete? Në këtë raport figuron që janë shpenzuar 69.260€ për ndërtimin e fushave sportive në Bllacë dhe Studenqan. Mirëpo gjendja e fushës në Bllacë është për keqardhje ndërsa ky projekt ka mbetur pa shpenzuar 10.000€. Në këtë raport figuron që për projektin “Rrethojat urbane “ju keni shpenzuar 113.000€. Lidhur me këtë projekt unë kam kërkuar sqarime dhe drejtori Visar më ishte përgjigjur duke thënë se ky projekt ka qenë premtim elektoral dhe se kanë me u bërë rrethojat e objekteve të komunës, shkollës “7 Marsi” ,gjimnazit “Jeta e Re” dhe shkollës “Shkëndija” në Suharekë. Mirëpo unë pata kritikuar atëherë për faktin se këto shkolla i kanë rrethojat, mirëpo ju vazhduat dhe e miratuat buxhetin pa përfillur kritikën tona. Por cila është e vërteta sot? Me këto mjete nuk u bënë rrethojat në asnjë nga këto institucione. Këto mjete u përdorën për krejt diçka tjetër, madje një pjesë e tyre u përdor për të sanuar fontanat e sheshit të cilat janë dëmtuar për një kohë kaq të shkurtër. Të dashur kuvendar e qytetar, këto janë vetëm disa pjesë të dështimeve të këtij pushteti. Lidhur me këtë ne si grup i kuvendarëve të LDK-së kemi kërkuar që të formohet një komision i të gjitha partive dhe të verifikohen të gjitha projektet që kemi miratuar në Asambleenë komunale dhe si janë realizuar por ju votuat kundër atëherë. Tani unë po kërkoj prap që të bëhemi bashkë dhe të themelojmë komisionin e përbashkët dhe i shohim në detaje këto shqetësime. Në fund dua që secilit prej jush t’i bëjë një gjë të çartë. Unë para kësaj kritike sot, ju kam kritikuar edhe në raportin 3 muajor ku keni shpenzuar vetëm 1% të buxhetit. Unë ju kam kritikuar edhe në raportin 6 muajor ku ju keni shpenzuar vetëm 8% të buxhetit. Unë ju kam kritikuar edhe për raportin 9 muajor kur ju keni shpenzuar vetëm 22% të buxhetit por ju nuk dëgjuat, prandaj dhe dështuat edhe në raportin përfundimtar të vitit 2023 ku kanë mbetur rreth 2 milion€. Njëjtë unë ju kam kritikuar mbi një vit për problemet me kontratat, ju nuk dëgjuat dhe në fund përfunduat me aktakuza e arrestime. Po ashtu unë ju kam kritikuar edhe për numërimin gabim të votave për buxhetin e vitit 2024 mirëpo ju nuk dëgjuat dhe të nesërmen thirrët seancë të jashtëzakonshme për miratim të buxhetit. Andaj është koha të reflektoni e ndryshoni sepse vet me vendimet tuaja po dëshmoni që keni dështuar të përmbushni edhe atë planifikim të keq që e keni bërë. Normalisht që jemi kundër këtij raporti e do vazhdojmë të jemi kundër kësaj logjike të mbrapsht qeverisëse.

**Selman Kolgeci** - ky raport mendoj që është i cekët edhe në kuptimin e rolit që e ka. Qeverisja komunale si sponsorizues i këtij raporti mendoj që duhet t’na informonte edhe me disa çështje tjera me rëndësi të cilat janë paraqitur në këtë raport por mungojnë informacionet tjera bazike dhe do të garantonte më shumë transparencë për mënyrën e buxhetit p.sh. për mënyrën e shpenzimeve kapitale. A është shpenzuar buxheti në përputhje me listën e investimeve të miratuara nga Asambleja? A është në përputhje me planin e prokurimit që i keni prezantuar këtij kuvendi? Nëse jo, cilat janë projektet jashtë listës dhe sa është vlera e tyre? Që disa vite po përdoret një praktikë e raportimit të formës shabllon që shkarkohet prej Ministrisë së Financave dhe nuk mendoj që ky lloj raportimi është raportim i saktë. Nga kjo marrë shkas që t’u drejtohem drejtorave të cilët mund t’kenë qenë menaxher të disa nga shumë projekteve të cilat në teren janë ekzekutuar ndërsa në raportin e administrimit të buxhetit nuk janë përfshirë. Bëhet fjalë për Ripërtrirjen e qëndrueshme urbane në lagjen e vjetër të qytetit, dekorimi i qytetit për festat e fundvitit, furnizimi i shkollës me ujë të pijes në Vraniq, trajtimi dhe planifikimi i hapësirave gjelbëruese konform PZHK-së, ndërtimi i sheshit “Brigada 123” - vazhdim, e shumë projekte tjera. Ju lutem të na tregoni se për projektet në fjalë a është paguar? Nëse është paguar nga cili zë buxhetor është pagu? Nëse jo a figurojnë si obligime? Janë 451,937.25 mjete që janë dediku për investime kapitale nga buxheti i shtetit tonë e këto investime qytetarët tonë nuk do ti shohin asnjëherë më. Pra afër gjysmë milion euro i keni kthyer dhe siq e dimë ato mjete nuk kthehen më. Po ashtu 1,583,902.90 janë pa u shpenzuar nga të hyrat vetanake. Më shumë se gjysmën e parave që i keni marrë nga qytetarët e komunës tonë, nuk ia keni kthyer në investim qytetarëve. Në total janë

mbi 2 milion euro të pa investuara. Kaq po ju kushton qytetarëve tonë paaftësia e kësaj qeverisje vetëm për vitin 2023. A nuk po keni ide zhvillimore apo jeni dorëzë? Sot do të ishte mirë të ishte prezent edhe Kryetari Muharremaj e t'na tregonte pse ky dështim, e ta mbronte fjalën e vet publike që u krekoste publikisht se kam ide e projekte që me pas buxhetin e Gjermanisë nuk e kthej asnjë cent suficit. Pres sqarime për projektet që u diskutuan.

**Kryesuesi** - ceke disa projekte dhe ceke se a ka fatura të pa paguara. Besoj që ato që janë të prezantuara si fatura të pa paguara janë të regjistruara.

**Fadil Hoxha** - te pjesa e projekteve kapitale janë me datë se kur janë nxerr prej free balancit dhe janë me emra ato që janë aprovu në buxhetin e 2023-tës. A janë shpenzu ato me atë emër duhet me analitikë me pa. Ai projekt me atë emër dhe ai shpenzim që është i shkruar, janë të sakta që kanë ndodh.

**Selman Kolgeci** - unë kërkoj që ato informacione që ti i ke, me na i prezantu neve pavarësisht prej volumit të fletëve që mund ti ketë. Në asnjë pikë unë nuk kisha pykëpyetjet e mia se a janë shpenzu a jo ku ju i keni shënu si shpenzim, unë e di që ajo nuk mundet me ndodhë por ideja ishte për projektet që përmenda.

**Fadil Hoxha** - edhe në pasqyrat financiare tregohen faturat e pa paguara që kanë mbet. E keqja e kësaj është dy herë sepse në një anë ke shku suficit dhe në anën tjetër ke obligime të pa paguara për 2023-tën. ZKF tutje jep sqarime dhe thotë që listën që po e kërkon ti me pa, unë mund t'ia përcjelli secilit asambleist që e bën kërkesën.

**Selman Kolgeci** - mendoj që për raportimet tjera edhe kjo listë do t'na shërbente neve për me dal ky raport kredibil sepse për situatën në të cilën ndodhemi për mendimin tim ky nuk është kredibil. Ne nuk kemi pasqyrë të saktë të shpenzimeve. Shumë i qartë isha në pyetje dhe as një përgjigje nuk pe marrë.

**Fadil Hoxha** - ato projekte që janë aprovu, ato emra i ke dhe bartjen 886.000. Mos thuaj që nuk është kredibil sepse është dokument zyrtar që është bërë shpenzim. A ka ndodh shpenzimi i saktë dhe a është në rregull lenda, është diçka tjetër dhe duhet dikush tjetër me ardhë me vendos.

**Selman Kolgeci** - z. Hoxha, nuk thash që ti ke pagu diçka që nuk e ke kry. Pyeta se përcjelli zë buxhetor ke pagu për këto 3-4 projekte.

**Alban Berisha** - e falemnderoj z. Hoxhën që e elaboroj raportin por pat kritika për disa projekte dhe kam dëshirë prej ekzekutivit me pas një arsyetim sepse z. Hoxha e bën arsyetimin teknik të raportit. Janë drejtorat përkatës se si i kanë shpenzu ato pare dhe nëse ka vërejtje është e rrugës me na dhënë sqarime.

**Urim Suka** - unë specifikisht kërkoja te disa projekte konkrete disa çështje që nuk po marrë shpjegim dhe askush nuk po e merr mundin me dhënë shpjegim. Kjo është e rëndë. Urim Suka paraqet shetësimet e tij të cilat i ngriti më herët dhe kërkon sqarime.

**Flamur Bytyçi** - ky material ka mos përputhje me atë që e kemi dhe e tha edhe zyrtari financiar. Andaj unë kërkoj prej jush Kryesues që mos me na ardh materiale të tilla me këso gabime. Kërkoj prej jush dhe prej kolegëve asambleist që këtë diskutim me shty seancën e radhës dhe materiali me na ardhë me shifra të sakta. Unë desha me diskutu por s'dua të diskutoj për deri sa kemi një raport me gabime.

**Agim Bylykbashi** - meqenëse unë jam drejtor që 2 muaj e gjysmë nuk mund të jap shumë informata sepse nuk kam. Për rrugën "Skënderbeu" mund të them që ato mjete janë shpenzu në kolektor. Sa i përket rrugëve në Samadraxhë janë dy projekte të ndryshme. Është asfaltimi i unazës që është kry dhe projekti rruga "Feim Morina dhe Bunari i Limanit" i ka përfshi të gjitha rrugët që e përfshin atë zonë, janë shtrua disa rrugë. Nuk mund t'ju japim detaje për secilin projekt por secili prej jush mund të bëni kërkesë zyrtare, me kërkim informata për secilin projekt dhe ne jemi në gjendje t'ju japim përgjigje.

**Urim Suka** - Kolektori është planifikim tjetër dhe unë po flas për një planifikim tjetër.

**Agim Bylykbashi** - e vërteta është se është projekt i veçantë. Është rruga "Skënderbeu" me disa rrugë të parapara dhe kolektori veq. Është e njejtja rrugë. Këto mjete nga ai projekt që është i rrugës "Skënderbeu" janë pagu për kolektorin. Kryetari ka të drejtë me marrë vendim të bartjeve të mjeteve në disa projekte të cilat ka nevojë me shpenzu.

**Labinot Halitjaha** - për pyetjen që e bëre, ka ardhë shkresa prej partisë tuaj dhe bashkë me Agimin e kemi sqaru dhe përgjigja vjen në zyre të partisë.

**Qëndrim Elshani** - shumë mirë që kemi ekonomista në Kuvendin tonë dhe po i elaborojnë mirë këto çështje por duke dasht mi përmend disa gjëra kryesore me siguri po i harrojnë disa gjëra mes



rreshtave.Shuma 13,434.02 për dreka në Drejtorinë e Kulturës.Shumë lehtë është me i thënë djemve të Suharekës të njohur si gjebrailat jo për kërkesat e tyre për me i bë disa grafiti qysh edhe u bë afër shkollës së gjimnazit për shkak të mjeteve.Ndoshta do të ishte më mirë që një shumë të drekave zyrtare me nda për qato grafiti sepse besoj që do i kontribonte shumë më mirë komunës tonë.

**Shefket Kolgeci** - aq janë adresat e pasakta sa s'ke idenë se ku janë këto rrugë.P.sh. Ndërtimi i rrugëve lokale"Parajsa" në Bre;Ndërtimi i rrugëve lokale"Bjeshka e Budakovës",Mehmet Xha;Ndërtimi i rrugëve lokale"8 Marsi dhe Gjirokastra D";Ndërtimi i rrugëve lokale"Besim Neziraj"-seg,"Jetush B.";Ndërtimi i rrugëve"Rexhep Zmajlaj.Shaban Rexhepi.Dan";Ndërtimi i rrugëve"Bajram Sh Kryeziu,Mal Hajdari.Xh";Ndërtimi i rrugëve"Donika Kastrioti,Zia Prishtina.AD";Ndërtimi i rrugëve lokale"Imer Munishi,Imer Munish Rama,Livadhet e bi".A është e qëllimshme apo gabim nuk e di.

**Urim Suka** - po e marrë si të mirëqen përgjigjen që drejtori tha që e merrni edhe me shkrim lidhur me shpenzimet e 300 mijë eurove për rrugët në Suharekë që kanë qenë dhe që i keni qu te kolektori.Te kolektori ku ka qenë planifikimi afër 300.000€ janë të shpenzuara dhe edhe 300.000€ nëse janë marrë dhe kanë shku atje,bëjnë afër 600.000€ dhe në teren shumë pak punë janë bë.Kjo po i bie që janë kry pagesa pa u kry punët.

**Lorika Gashi** - Jo Qëndrim nuk mu kanë duk shumë duke e marrë parasysh sa aktivitete ka pas në dreka zyrtare.Nëse e sheh të arsyeshme mund ta dërgoj edhe një raport me shkrim për të gjitha shpenzimet që janë bë për dreka se ku kanë shku dhe listen e musafirëve.Shuma të mëdha kanë shku në "Festar",në"13 Qershor".

**Shefket Kolgeci** - unë e kam kërkuar një investim me furnizu shkollën me ujë në Vraniq.Ne kemi mendu që gjatë pushimit të verës me kry atë punë por nuk u kry.Dua të di se deri ku kanë arrit me këtë punë.

**Remzi Bajselmani** - edhe unë kam qenë vullnetmirë për me kry këtë punë duke e falemderu edhe Selmanin për kontributin që ka dhënë për projektin.Projekti është realizu,është lëshu uji.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**17 për, 11 kundër  
Miratohet pika 4**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i raportit të performancës për vitin 2022 të Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - hap debatin për këtë pikë.

**Urim Suka** - kur jemi te raporti i vlerësimit të performances së komunave,këto ditë kemi pa disa postime propaganduese kinse Suhareka është e para në këtë raport.Mirëpo për dallim nga ju unë para prezantimit të të dhënave e lexoj raportin pastaj flas mbi bazën e të dhënave që dalin nga raporti.Më lejoni të ju njoftoj me disa të dhëna nga ky raport.Të përfshira në raport kanë qenë 30 komuna,vlerësimi është bërë për 19 fusha me 111 tregues për të gjitha fushat.Fusha-Shërbimet publike administrative,Suhareka renditet e 21-ta; fusha -Barazia në punësim,shërbime sociale dhe familja,Suhareka renditet e 19-ta.Fusha -Kulturë rini dhe sport,Suhareka renditet e 18-ta; fusha- Menaxhim i fatkeqësive,Suhareka renditet e 25-ta;Fusha-Hapsirat publike,Suhareka renditet e 27-ta;fusha-Transporti publik,Suhareka renditet e 15-ta;fusha-Uji i pijshëm,Suhareka renditet e 22-ta;fusha-Mbrojtja e mjedisit,Suhareka renditet e 16-ta;fusha-përfaqësim gjinor,Suhareka renditet e 17-ta;fusha-kujdesi primar shëndetësor,Suhareka renditet e 11-ta;fusha-Zhvillimi ekonomikë lokal,Suhareka renditet e 13-ta.Sa i përket raportit të arsimit,kur i lexova treguesit e matjes që ka përdor ministria për arsimin,kuptova që një pjesë e fajit ishin te treguesit.Treguesit që ishin te matje pothuaj fare nuk kishin të bënin me menaxhimin e DKA për të cilin këta janë krekos që kanë dal të parët.Për t'ju kujtuar se si është menaxhimi mbi bazën e kompetencave që keni ju,po përmend disa probleme që ju kanë përcjell këtë kohë.Zgjedhja e drejtorave me emrime politike përkundër premtimeve që keni pas.Rekrutimi i stafit të mësimdhësve,rekrutime pa konkurs,sistemi i mësimdhënësve,furnizimi me dru,meremetimi i shkollave(punë pa kritere,vonesa në kryerjen e punëve),në aneksin e shkollës në Maqitevë 10 mijë euro kanë shku sufucit,në vitin 2022 plot fatura i kanë mbet shkollave pa paguar për shkak të neglizhencës së DKA-së, e shumë probleme tjera.Ajo propaganda

që e keni bë në facebook nuk ka të bëjë asgjë me ralitetin qka thotë raporti e aq më pak çka thotë gjendja në teren.

**Selman Kolgeci** - ajo që po vërehet është se një pjesë e madhe e diagrameve që tregojnë performacën e komunës tonë, komuna jonë është nën mesatare. Unë dua të flas për menaxhimin e fatkeqësive. Është rezultat krejt tjetër nga ajo që jemi mësuar ta shohim se si Kryetari bën abrokacione nëpër rrjete sociale, si rrjedhojë të fusha që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore si dhe niveli i përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Pra për këto dy fusha komuna jonë rezultojnë të renditet e parafundit në nivel të komunave të Kosovës. Në fakt kur e shohim këtë rezultat na lë të kuptojmë sa që opinionet tona e këndvështrimi jonë në lidhje me popullizmat e Kryetarit Muharremaj kanë qenë të drejta edhe për këtë fushë. Pra një mungesë e planit konkret për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore e një dështimi, të një qeverisje komunale në këtë fushë, Kryetari Muharremaj ka vendosur që ta mbulojë me qizme e dushk.

## **Pika 6. Informatë për aktivitete e KKSB-së;**

**Kryesuesi** - hap debatin.

**Alban Berisha** - e shoh që shumica e raportit është përsëritje. E lexova që ka edhe shqetësime të Kryetarit ku nuk varet prej tij por janë organet e sigurisë ku nuk po bëhet sa duhet dhe pajtohem me vërejtjet që i ka dhënë Kryetari. Por çka nuk pajtohem? Te mjetet piroteknike nga data 23.12.2023 deri më 03.01.2024 lejohet shitja e mjeteve piroteknike dhe lokacioni caktohet të tregu javor. Tregu javor a quhet krejt Suhareka apo është ndonjë vend që nuk e di unë? E kam thënë edhe vitin e kaluar dhe po e them edhe sot. N'krejt tjerat ke pas mundësi me ble mjete piroteknike përveq në barnatore. E di arsyetimin e Kryetarit por shitjen mund ta menaxhojë kuvendi komunal dhe të përcillen se a po i shiten fëmijëve. Këtu thuhet se sa i përket shkollave ka përmirësime, gjithëashtu vendosja e kamerave ka ndikuar që ne të kemi më pak punë dhe të ndiqen dhe zbulohen personat e dyshimtë. Kamerat janë prej buxhetit tonë dhe menaxhimin e kanë policia. Faktikisht unë nuk e di sa vjedhje janë, sa shkelje ligjore dhe ku u zbulu. Asnjëherë raport nuk kemi pas. Këtu thuhet ti largojmë fëmijët tonë nga dukuritë negative dhe ti orientojmë nga sporti dhe kultura. Për me u bo këto duhet me u bë edhe kënde të lojërave nëpër lagje, jo vetëm në qytet por edhe nëpër fshatra.

Drejtor i Urbanizmit, sa e ke nivelin e kënaqshmërisë ti personalisht si qytetar me vendosjen e shtëpizave në sheshin e Suharekës? A ka qenë funksionale pisha e qytetit që Kryetari ka dalë në mënyrë publike me bo ndezjen e dritave? A e keni pa ndonjëherë me sy një familje me fëmijë duke u shetit në shesh për të cilin është i destinuar ai shesh dhe a keni llogarit që ana përball sheshit është shumë keq i planifikuar ai trotuar. Degjenerim total në 11-12 të natës aty që ka ndodhë dhe nuk e di a keni pas ankesa prej atyre banorëve për shkak të zhurmës dhe mbeturinave që janë bë dhe çfarë masa keni ndërmarrë.

**Visar Kuçi** - edhe si qytetar dhe si drejtor aspak nuk kam qenë i kënaqur, jo me sheshin por me respektimin e pëlqimeve që i kanë marrë ata operatorë. Si rrjedhojë e kësaj, unë e kam bë një kërkesë në zyrën e Kryetarit, e kam formu një komision për me hartu një rregullore për sheshin e Komunës.

**Shefket Kolgeci** - që tri vite e kam cek çështjen e qenve endacak. E pash që në KKSB 4 mbledhjet e fundit nuk është diskutuar asnjëherë kjo çështje. Ne edhe si grup parlamentar kemi thënë që me bë një zgjidhje për qentë endacak. Herën e kaluar kur e kam ngrit këtë shqetësim, Kryetari tha që s'ka ligj. Deri sa ka ligj për komunat tjera, sigurisht ligji është edhe për komunën tonë. Herën e kaluar e kam cek që Mitrovica ka nis me bë një strehimore, tani edhe Peja ka fillu. Ne e kërkojmë prap nga Kryetari, qeveria që të merrni hapa në këtë drejtim dhe të bëni një zgjidhje me qentë endacak por edhe të siguron një strehimore për ta dhe ne ti aprovojmë mjetet. Unë besoj që të gjithë kolegët pajtohen me mua sepse është shqetësuese dhe unë mendoj që komuna jonë ka hapsira dhe vende për me bë atë strehimore.

**Selman Kolgeci** - sa i përket kësaj pike e them me bindje të plotë që Kryetari i komunës si kryesues i KKSB-së është duke bë shumë pak në lidhje me ofrimin e zgjidhjeve të disa nga shumë probleme dhe shqetësimet. Në shumë prej informatave për pikat e përfshira në aktivitetet e KKSB-së pam që kishte vetëm konkluzione, raportime për shifra e konkluzione sipërfaqësore. P.sh. në takimin e 4 njera ndër temat ka qenë: identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevojë të veqanta. Për këtë pikë në këtë

informatë thuhet se komuna jonë renditet e para për krijimin e kushteve për qasje të kësaj kategorie në objektet institucionale dhe në vendet ku kjo kategori frekuenton. Ky deklaram nuk qëndron sikurse konkluzioni për këtë pikë nuk qëndron sepse komuna jonë në objektet e saj nuk ka krijuar qasje për këtë kategori. Pra një person me nevoja të veqanta nuk ka akses në katet e para të objektit të komunës. Po ashtu në takimin e 5 të KKSB-së njëra ndër temat ka qenë raportimi për siguri në komunikacion. Edhe për këtë pikë na është ofruar e dhënë se sa ka qenë numri i aksidenteve, numri i gjobave, numri i patrullimeve, numri i konfiskimit të patent shoferëve dhe si konkluzion është thënë se do të marrin aksione më të shpeshta për matjen e shpejtësisë dhe për lirin e trotuareve. Kryetari në cilësinë e kryesuesit të KKSB-së duhet të ofroj zgjidhje konkrete, duhet të prezantoj ide të qëndrueshme, qoftë për trajtimin e pikave të zeza dhe ofrimin për zgjidhjen e tyre, qoftë për rritjen e nivelit të informimit të ngasësve duke përdorur sinjalizim adekuatë.

**Alban Berisha** - pa e marr personale asnjëri prej juve kisha pas dëshir si qytetar dhe si prind për ju si ekzekutiv me dal me dhënë një sqarim në mënyrë publike sepse e kemi një akuzë përmes rrjeteve sociale në facebook, akuzë shumë e rëndë për mua dhe për secilin qytetar. Nuk jam duke prediku apsolutisht, as në mënyrë hipotetike e as kurqysh që aty ka ndodh diçka por frikën e kemi krejt. Unë e di që mund të jetë në fazën e hetimeve dhe nuk mund të jep askush detaje por përball një akuze shumë të rëndë, diçka që është themelore për jetën tonë, shkolla ku ne i dërgojmë fëmijët me u eduku dhe me mësu, e në vendin ku ne mendojmë që i kemi fëmijët më të sigurtë, me pas akuza që s'janë sigurt hiq dhe me ra një heshtje totale nuk ka nevojë prej gazetarëve me dhënë sqarim, duhet me dal dikush me dhënë një sqarim pavarësisht çmimit dhe përgjegjësisë.

#### **Pika 7. Raporti i ekipit të auditimit social për Suharekë;**

**Kryesuesi** - ia jep fjalën Rrahman Ramaj nga organizata Birn.

**Rrahman Ramaj** - auditimi social nisi të implementohet nga DEMOS që nga viti 2022 ndërsa angazhimi dhe bashkëpunimi me BIRN filloi nga mesi i vitit 2023 në programin e krijimeve të ekipeve të auditimit social në 5 komuna të ndryshme. Siq dihet mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të grantit të performancës ku komuna e Suharekës është njëra prej përfituesve të grantit të performancës dhe komuna ka përzgjedhur projektin Ndërtimi i shtegut dhe rrugës Mushtisht-Guri i Matozit si dhe rrugën Topliqan-Gjinoc për të realizuar përmes grantit të performancës. Ekipi i auditimit social fillimisht ka paraqitur kërkesa për qasje në dokumenta publike në Komunën e Suharekës, më pas për evidentimin e gjetjeve ka realizuar vizita në teren, ka realizuar takime me zyrtar përgjegjës dhe me Kryetarin e Komunës dhe si përfundim ka ardhë në relizimin e një raporti prej 30 faqes. Rrahman Ramaj tutje elaboron në pika të shkurta raportin.

**Selman Kolgeci** - te përmbledhja, në fund e keni cek se pas analizimit të projektit grupi gjeti se projekti nuk garanton mbrojtje për këmbësorët që lëvizin rreth zonës. Sa është i rrezikshëm lëshimi në funksion i shtegut të ecjes në Mushtisht për qytetarët?

**Rrahman Ramaj** - ekipi i auditimit social e ka evidentu që për shkak të terrenit është më se e nevojshme vendosja e barierave. Mendoj që këtë aspekt mund të kontribuoj më shumë Reshat Selimaj që ka qenë kryesues dhe Visar Kuçi menaxher i kontratës.

**Selman Kolgeci** - nëse nuk garanton një mbrojtje dhe është një rrezikshmëri për qytetarët, mendoj që duhet ti shtohet një rekomandim që Komuna me një projekt tjetër me i vendos pahitë skaj shetitores.

**Visar Kuçi** - është kritikë me vend. Fillimisht shetitorja ka qenë në pjesën e kundërt të rrugës mirëpo me kërkesën e banorëve dhe të ekipit është zhvendos në pjesën ka lumi. E kemi në planifikim dhe do të vendosen sepse është e rrezikshme.

**Urim Suka** - u përmend projekti në Mushtisht dhe Topliqan. A janë përmbyll si projekte komplet?

Nën menaxhimin e tyre dhe sa telashe kanë dalë!

**Visar Kuçi** - Pajtohem me ty. Raportin kur e kanë përfundu BIRN bashkë me fshatin, gjatë punimeve këta i kanë dhënë vërejtjet dhe ne i kemi përmirësuar gjatë realizimit të projektit. Për mua është shembull i mirë dhe publikisht kam kërku me na monitoru edhe këtë vit.

**Jehona Rrafshi** - a keni menduar ndonjëherë të mbani trajnim me ne si anëtar të Kuvendit për mbikqyrjen gjithëpërfshirëse të Kuvendit në Suharekë? Siq jam në dijeni në Dragash para dy viteve keni mbjartë disa trajnime dy ditore.

**Rrahman Rama** - konkretisht nuk kam informacione se a do të ketë në K. Suharekës mirëpo do të ishte mirë me u mbajtur edhe në Suharekë.

#### **Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;**

**Urim Suka** - kam një shqetësim sepse muajin e kaluar unë i kam adresu disa pyetje dhe nuk kam marrë përgjigje. Njëra prej pyetjeve ka qenë te miratimi i buxhetit, ku asambleistat e juaj i kanë bërë propozimet për buxhet dhe janë votu një nga një dhe ato propozime nuk kanë figurë më në dokument. Kjo është skandal dhe duhet të jap dikush llogari se çka ka ndodh. Lus secilin asambleist ti ngulim këmbët në këtë temë. Dhe çështja e raportit financiar që e keni sjell, sot na dolën të dhëna të reja. Ne e votuam atë që e keni dhënë ju dhe sot ai fliste me të dhëna tjera dhe kjo ska kuptim.

Ditë më parë me kërkesë të qytetarëve kam vizituar shtratin e lumit Mirusha në Bllacë ku kam parë që lumi ka dal nga shtrati duke dëmtuar tokat bujqësore. Këtë problem e kam ngrit edhe në seancat tjera mirëpo nuk është intervenuar përkundër që keni pas kontratë. Kur pritet që të investohet në shtratin e lumit të fshatit Bllacë që të evitohet ky problem? Pushteti juaj ka lidhur një kontratë për rregullimin e rrugës „Ushtari i Lirisë“-segment. Nga vizita dhe nga informatat që mora nga banorët atje pashë që rruga „Ushtari i Lirisë“ dhe një rrugë tjetër ishin përgaditur për tu shtruar me asfalt mirëpo asfalti nuk është shtruar fare dhe me sa e di as tash nuk është shtruar dhe ato 5000€ që kanë qenë të kontraktuara në raport figurojnë që kanë shkuar suficit. Kur do të shtrohen këto rrugë me asfalt? Disa shqetësime të pacientëve lidhur me furnizimin e tyre me barna nga barnatorja e QKMF-së. Kam disa informata nga qytetarët që personeli që janë të angazhuar aty po i neglizhojnë dhe po krijojnë pritje të panevojshme për pacientët. Gjithëashtu në bazë të informatave që kam, personeli i depos furnizon urgjencën në mënyrë jo profesionale me barna. Problem tjetër në urgjencë është edhe mungesa e ngrohjes qendrore gjatë orëve të mbrëmjes. Kërkoj sqarime nga Drejtoria e Shëndetësië ose nga dikush tjetër pasi drejtoresh nuk është.

**Agim Bylykbashi** - projekti për pastrimin e lumenjëve të lumin Toplluha dhe të tjerë është kontraktuar kompania para viti të ri. Është mirë që kryetari fshatit me sjell një kërkesë zyrtare. Sa i përket projektit në Vërshëc, kompania që e ka marrë tenderin nuk i ka kryer punimet dhe nuk e kemi pagu.

**Labinot Halitjaha** - kur është votu buxheti ka pas disa kërkesa dhe ne i kemi marrë të dhënat por kur është bërë buxheti, ka me shkronja se sa shkronja duhet me u fut me një kolonë. Pra nuk kemi mujt me i fut në kuptimin si emra ndërsa me bartjen e të hyrave vetanake ne këto investime kemi me i fut në paramasë dhe kemi me i kry premtimet.

**Urim Suka** - propozimet e tyre nuk kanë hy. Unë e kam marrë dokumentin që është miratu dhe kur i ka shku ministrisë ato nuk kanë hy. Fakti që ju në ato dokumente që ju i miratoni këtu, i ndryshoni në zyre qysh doni ju, është skandal i llojit të vet dhe normal dikush duhet me dhënë llogari. Jo për veq si rast por për si fenomen mos me na ndodh më.

**Doruntina Zenelaj** - para 6 viteve është bërë një kërkesë nga banorët e fshatit Savrovë që të ndryshohet segmenti i fundit i rrugës „Ledina Halimit“ dhe të emërtohet ky segment me emrin rruga „Beqir Abazi“. Emërtimi është aprovu por ende nuk është vendos emërtimi i ri në tabel. Pse nuk është vendos? E njejt rrugë është rregullu nga vet banorët e lagjes me vet financim me kubëza por të njejt për shkak të vërshimeve kanë filluar të bien në përrok dhe është filluar të shembet dhe muri mbrojtës me gjatësi rreth 100 m duke rrezikuar kalimtarët dhe veturat, për të cilën kërkojnë nga drejtoria e shërbimeve publike të intervenohet me rregullimin e këtij muri mbrojtës. Gjithëashtu kërkojnë që ky seg. i rrugës të paiset me rrjet të qëndrimit publik me gjatësi rreth 350 m. Në vitin 2023 ndër të tjera janë planifikuar edhe rrugët „Livadhet e buta dhe Rifat Zenelaj“ mirëpo këto rrugë nuk janë shtruar. Pse nuk janë shtruar këto rrugë? Gjithëashtu edhe për rrethojat e varrezave ka qenë e planifikuar në vitin 2022, nuk është përfundu ende. Pse nuk është përfundu dhe a planifikoni ti bëni rrethojat e varrezave?

**Visar Kuçi** - në fund të 2016-tës ka përfundu procesi i emërimit të rrugëve dhe pasi ka përfundu procesi është formu komisioni për ankesa dhe të gjitha ankesat që u janë aprovu qytetarëve nuk kanë hy kurrë në

sistem të adresave dhe nuk e di pse. Vitin e kaluar agjensioni kadasral na ka sjell dy punëtor dhe kemi fillu me i fut në sistem. Janë duke i kry fshatrat tjerë dhe seancën tjetër do të kthej përgjigje.

**Agim Bylykbashi** - kërkoj falje por nuk jam në dijeni dhe duhet të marr informata të sakta se çka ka ndodh dhe çka mund të bëjmë. Projekt për mure nuk kemi sepse nuk na lejon me pas në fond emërgjent. Ka pas më herët. Në projektet e ardhshme duhet të parashihen edhe muret mbrojtëse.

**Lirim Qatani** - me që u përmend shëndetësia e ndiej obligim me që u cek edhe urgjenca. Vërtetë shqetësimet që i ngriti Urimi qëndrojnë.

**Jehona Rrafshi** - është një shqetësim i një banori në fshatin Bllacë për rrugës "Atlantika". Për këtë rrugë kemi bisedu shumë herë dhe është fut në buxhet disa herë dhe ka qenë kërkesë edhe prej këshillit të fshatit dhe kjo rrugë qëndron 5-6 vjet të njëjtën gjendje. Kërkoj publikisht nga drejtori i Shërbimeve Publike që nesër të vje dhe ta shesh gjendjen e kësaj rruge.

Takimi përfundoi: 16:00

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj